

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6755
E premte, 11 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

KQZ-ja rekomandon kandidatët për zëvendësimin e deputetëve të dorëhequr serbë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HOVENIERI: JEMI TË SHQETËSUAR PËR SITUATËN NË VERI

FAQE 4



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se janë të shqetësuar për situatën në veri. Ai i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që t'i nisë urgjentisht negociatat për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Gjithashtu, sërish ka kërkuar që qeveria ta

shtyjë për dhjetë muaj zbatimin e planit për riregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Ambasadori amerikan ka theksuar se ka pasur kontakte të vazhdueshme me Qeverinë e Kosovës, por ka shtuar se "nuk mund të konfirmojë se qeveria ka ndërmarrë veprimet që ia kemi kërkuar"

VENDIMI PËR VIZAT SË SHPEJTI, HYRJA NË FUQI NË NËNTOR 2023

FAQE 2



OPOZITA KRITIKON QEVERINË PËR "PRISHJE TË PARTNERITETIT NDËRKOMBËTAR"

FAQE 3

KEDS-i: NGRUHJA ME RRYMË JUA RIT FATURËN PËR 70 PËR QIND

F. 8

NDAHEN 15 MILIONË EURO PËR REZERVËN SHTETËRORE, ORIGJINA E PRODUKTEVE KRYESISHT NGA KOSOVA

F. 8

SPORT



LLAPI SHKATËRROI BALLKANIN, S'KA FITUES NË DERBIN E ANAMORAVËS

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vendimi për vizat së shpejti, hyrja në fuqi në nëntor 2023

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Vendet anëtare të BE-së në takimin e grupit punues për vizat kanë përafuar qëndrimet rreth një kompromisi, sipas të cilit, do të miratohej vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën, që do të hynte në fuqi më 1 nëntor 2023, kur do të nisë zbatimi edhe i sistemit evropian të informimit dhe autorizimit të udhëtimit (ETIAS).

Sic mëson "Radio Evropa e Lirë" nga burimet diplomatike, ky ka qenë kompromisi mes kërkesës së Francës për kushtëzimin e hyrjes në fuqi të liberalizimit të vizave me nisjen e zbatimit të ETIAS-it dhe kundërshtimit të shumë vendeve të tjera që kjo të mos lidhet. Në fund është përmendur edhe ETIAS-i, por edhe data.

Grupi punues për vizat në Këshillin e Bashkimit Evropian ka diskutuar sot, për herë të dytë, për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Diskutimi i parë është zhvilluar më 13 tetor, kur shumica e vendeve anëtare të BE-së e kanë mbështetur liberalizimin e vizave për Kosovën.

Franca, megjithatë, ka kërkuar që hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave të lidhet me funksionalizimin e sistemit të udhëtimit ETIAS.

Ky sistem digjital synon ta bëjë evidentimin e vizitorëve që hyjnë prej jashtë BE-së në zonën e lëvizjes së lirë, Schengen. Ai është dashur të nisë së funksionuari në vitin 2022, por data është shtyrë disa herë dhe tani si afat përmendet nëntori i vitit 2023.



ShBA-ja dhe Japonia bëjnë stërvitje ushtarake si përgjigje ndaj Kinës dhe Koresë së Veriut

WASHINGTON, 10 NËNTOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia nisën stërvitje ushtarake të përbashkëta të enjten, në pjesën jugore të Japonisë, si tentim për rritjen e gatishmërisë shkaku i veprimeve të Kinës dhe shtimit të lëshimeve të raketave nga Koreja e Veriut.

Stërvitjet "Keen Sword", që zhvillohen çdo dy vjet, nisën në një bazë ajrore japoneze dhe, deri tash, u mbajtën në disa vende përreth Japonisë. Ato do të zgjasin deri më 19 nëntor.

Rreth 26 mijë japonezë dhe rreth 10 mijë trupa amerikane, së bashku me 30 anije dhe 370 avionë nga të dyja palët, do të marrin pjesë në këto stërvitje, sipas Ministrisë së Mbrojtjes të Japonisë. Australia, Bahreini dhe Kanadaja do t'u bashkohen disa pjesëve të ushtrimeve, sipas



kësaj ministrie.

Stërvitjet e përbashkëta fushore janë planifikuar të zhvillohen në disa ishuj të largët në jugperëndim të Japonisë, si: Tokunoshima, Amami dhe Tsutarajima.

Japonia po i shton kapacitetet mbrojtëse në rajon, mes tensioneve në ngritje me Kinën.

Kina i ka përforcuar pretendimet e saj për pothuajse gjithë Detin e Kinës Jugore duke ndërtuar ishuj artificialë të pajisur me instalime ushtarake dhe fusha ajrore. Pekini ka pretendime edhe për një varg ishujsh që kontrollohen nga Japonia në Detin e Kinës Lindore dhe ka rritur kërcënimet

ushtarake ndaj Tajvanit të vetëqeverisur, për të cilin thotë se është pjesë e Kinës dhe do të aneksohet me forcë nëse është e nevojshme.

Stërvitjet e përbashkëta po bëhen, gjithashtu, pas lansimit të raketave nga Koreja e Veriut - më shumë se 30 sosh vetëm këtë vit - duke përfshirë një të mërkurën që ra në detin midis Gadishullit Korean dhe Japonisë.

Muajin e kaluar një raketë balistike ndërkontinentale kaloi mbi Japoninë veriore.

Kryeministri Fumio Kishida, duke përmendur përkeqësimin e sigurisë në rajon, është zotuar t'i rrisë kapacitetet ushtarake japoneze dhe potencialisht ta lejojë ndërtimin e kapaciteteve për sulme parandaluese nga larg ndaj vendlëshimeve armike të raketave. Këto plane pritet të jenë pjesë e strategjisë së sigurisë

kombëtare, që është duke u rishikuar, dhe e udhëzimeve afatmesme dhe afatgjata për mbrojtje këtë vit.

Zhvillimi i kapaciteteve të sulmit përbën një ndryshim të madh në parimin e Japonisë që ka princip vetëm vetëmbrojtjen. Por, Japonia ka përforcuar me shpejtësi rolin dhe kapacitetet e ushtrisë së saj gjatë dekadës së fundit për të punuar më ngushtë me Shtetet e Bashkuara dhe partnerë të tjerë në rajon dhe Evropë.

Stërvitjet si "Keen Sword" u ofrojnë forcave japoneze dhe amerikane "mundësi për t'u stërvitur së bashku në një sërë fushash misioni në skenarë realistë për ta rritur gatishmërinë, ndërveprimin dhe për të arritur një parandalim kredibil", thuhej në një deklaratë të forcave të ShBA-së të enjten.

ShBA: Më shumë se 200 000 viktima nga lufta në Ukrainë

WASHINGTON, 10 NËNTOR - Forcat ukrainase kanë zbrapsur sulmet e reja ruse në rajonin lindor të Donjeckut, ku Moskua vazhdon të kryejë një ofensivë në drejtimet Bakhmut dhe Avdiyivka, ka thënë Shtabi i Përgjithshëm i Ukrainës.

Ndërkohë, gjeneral i lartë amerikan, Mark Milley, foli për "vuajtjet e jashtëzakonshme" dhe viktimat që sollti lufta mbi ukrainasit.

Luftimet e ashpra në lindje pasuan pas urdhrat të ministrit

rus të Mbrojtjes, Sergei Shoigu, për një tërheqje nga bregu perëndimor i lumit Dnieper në rajonin pjesërisht të pushtuar të Hersonit në pengesën e fundit të dukshme për Moskën në fushën e betejës në juglindje të Ukrainës.

Ushtria ukrainase tha se kishte zbrapsur, gjithashtu, sulmet ruse në rajonin e Luhanskut, i cili, së bashku me Donjeckun, përbëjnë rajonin Donbas të Ukrainës lindore.

Forcat ruse nisën sulme me

raketa dhe ajrore dhe goditën më shumë se 30 vendbanime në rajonet Donjeck, Luhansk, Dnipropetrovsk, Zaporizhja, Mikolajiv, Sumi dhe Herson, tha ushtria.

Gjenerali amerikan Milley tha se rreth 100 000 ushtarë rusë dhe rreth 100 000 ukrainas ishin vrarë ose plagosur në luftë, shifra më e lartë e përmendur deri më tani nga një zyrtar perëndimor.

Milley, duke folur në një ngjarje në Nju-Jork më 9 nëntor, tha se



rreth 40 000 civilë kishin vdekur pasi u kapën në konflikt.

Vlerësimet nuk mund të konfirmoheshin në mënyrë të pavarur.

KQZ-ja rekomandon kandidatët për zëvendësimin e deputetëve të dorëhequr serbë

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar të enjten rekomandimin e kandidatëve të radhës për zëvendësimin e dhjetë deputetëve të dorëhequr të Listës Serbe.

Deputetët e Listës Serbe kanë dhënë dorëheqje më 7 nëntor nga mandatet e tyre në Kuvendin e Kosovës në shenjë pakënaqësie me vendimin e Qeverisë së Kosovës për ta zbatuar planin prej tri fazash për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe.

Rekomandimet e kandidatëve nga KQZ-ja janë bërë pas kërkesës së presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani.

Kandidatët e rekomanduar nga Lista Serbe që do t'i zëvendësojnë deputetët e dorëhequr janë: Millan Kostiq, Zoran Maksimoviq, Olivera Zdravkoviq, Millan Joksimoviq, Ksenija Bozhoviq, Radosh Mihajllloviq, Nenad Radenkoviq, Svetislav Gjokiq, Biljana Makshiq dhe Cvetko Velkoviq nga Iniciativa Qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë.

Komuniteti serb, si më i madhi në mesin e komuniteteve pakicë

në Kosovë, i ka të garantuara me Kushtetutë dhjetë vende në Kuvendin e Kosovës, i cili ka gjithsej 120 ulëse.

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë parasheh që në rast të lirimimit të një mandati nga një deputet - për çfarëdo arsyeje, përfshirë edhe dorëheqjen - zëvendësimi i tij bëhet "nga kandidati i ligjshëm në radhë i së njëjtës gjini, i cili ka fituar numrin më të madh të votave" në emër të listës me të cilën ka garuar.

Çfarë ndodh nëse këta kandidatë nuk pranojnë të bëhen deputetë?

Komisioni Qendror Zgjedhor nuk i është përgjigjur kësaj pyetjeje të Radios Evropa e Lirë deri në publikimin e këtij artikulli. Por, ish-kryetarja e KQZ-së dhe gjyqtarja Valdete Daka, thotë se për deputetë mund të propozohen edhe serbë që kanë garuar në zgjedhje nga subjektet e tjera politike. "Nëse ata [kandidatët nga Lista Serbe] refuzojnë ta marrin mandatin, aplikohet e



njëta procedurë derisa të ketë kandidatë nga ai subjekt. Nëse nuk ka nga ai subjekt, atëherë kërkohen nga subjektet që kanë garuar në zgjedhjet e fundit të përgjithshme për vendet e rezervuara për etnitetin serb", thotë Daka për "Radion Evropa

e Lirë". Sipas të dhënave të KQZ-së, në zgjedhjet e fundit parlamentare kanë garuar edhe dy subjekte të tjera nga komuniteti serb: Lidhja Demokratike Serbe dhe Iniciativa Qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë.

Kandidatë nga e para kanë qenë Sllavisha Petkoviq, Mihajllo Shqepanoviq, Jasmina Zdravkoviq, Srbolub Andrejeviq dhe Esada Rexhepi, ndërsa nga e dyta Millan Dabiq, Cvetko Velkoviq dhe Rada Trajkoviq.

Opozita kritikon qeverinë për "prishje të partneritetit ndërkombëtar"

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, partisë në pushtet, Mimoza Kusari-Lila, u është drejtuar të enjten qytetarëve serbë nga Kuvendi i Kosovës. Me një mesazh në gjuhën serbe, Kusari-Lila u ka bërë thirrje qytetarëve serbë që janë larguar nga institucionet e Kosovës në ditët e fundit, të rikthehen në këto institucione.

Që nga 5 nëntori dhe në ditët në vazhdim, serbë të Kosovës kanë ofruar dorëheqje nga institucione

të ndryshme, në shenjë kundërshtimi ndaj zbatimit të planit të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e targave të makinave në pjesën veriore të vendit. Ndër ta edhe dhjetë deputetët e Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, kanë dorëzuar të hënën dorëheqjet e tyre.

Këta deputetë Kusari-Lila ka thënë se nuk i kanë përfaqësuar denjësisht serbët e Kosovës. "Ata asnjëherë gjatë këtij mandati nuk adresuan nevojat dhe nuk folën për interesat e qytetarëve serbë të Kosovës", ka thënë Kusari-Lila, duke shtuar se "ata kanë zgjedhur

ta përfaqësojnë autoritetin e regjimit të Serbisë".

Rikujtojmë se tashmë presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka dërguar kërkesë në Komisionin Qendror Zgjedhor që ta rekomandojë zëvendësimin e deputetëve të dorëhequr.

Pas fjalimit të deputetes së pozitës, shefat e grupeve parlamentare të partive opozitare e kritikuan qeverinë për situatën në katër komunat veriore të Kosovës dhe largimin e qytetarëve serbë nga institucionet. Ata i kërkuan qeverisë t'i marrë parasysh kërkesat e faktorit ndërkombëtar

që të shtyhet zbatimi i planit trefazësh që parasheh masa ndëshkuese për qytetarët që nuk i ndërrojnë targat e makinave.

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se duhet pasur kujdes për të mos u "zhbërë progresi i arritur në integrimin e asaj pjese të vendit".

"Jeni përgjegjës për mirëmbajtjen dhe ushtrimin e sovranitetit edhe në atë pjesë të vendit tonë. Ne do t'ju mbështesim deri në atë moment që ju nuk do të hiqni dorë nga ajo pjesë e vendit tonë", ka thënë Tahiri.

Deputeti nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Arben Gashi, ka thënë

se qeveria është fajtores që "sot në pjesën veriore të republikës kemi më pak institucione të Republikës". "Kryeministri ka për detyrë ta garantojë partneritetin ndërkombëtar", tha Gashi, duke iu referuar refuzimit të kërkesave të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shtyrjen e zbatimit të planit të targave.

Ndërkaq deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se, pos që duhet të respektohen kërkesat e ndërkombëtarëve, qeveria duhet të ketë edhe dialog intensiv me serbët e Kosovës dhe opozitën.



Hovenieri: Jemi të shqetësuar për situatën në veri

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se janë të shqetësuar për situatën në veri. Ai i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që t'i nisë urgjentisht negociatat për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Gjithashtu, sërish ka kërkuar që qeveria ta shtyjë për dhjetë muaj zbatimin e planit për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Ambasadori amerikan ka theksuar se ka pasur kontakte të vazhdueshme me Qeverinë e Kosovës, por ka shtuar se “nuk mund të konfirmojë se qeveria ka ndërmarrë veprimet që ia kemi kërkuar”

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës t'i nisë urgjentisht negociatat për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Duhet të ketë në tryezë një propozim për asociacionin”, ka theksuar Hovenier, duke shtuar se ai nuk duhet të jetë diçka që nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Në një takim me gazetarët në ndërtesën e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, Hovenier i ka bërë thirrje Qeverisë së

Kosovës ta shtyjë për dhjetë muaj zbatimin e planit për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Gjithashtu, ai ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk duhet të nisë gjobitjen e shoferëve që ngasin makina me targa të tilla. Hovenieri ka thënë se e ka kërkuar një gjë të tillë nga qeveria. I pyetur nëse ajo u është përgjigjur kërkesave të tij, Hovenieri ka theksuar: “Mendoj se ju e dini, ashtu sikurse unë, se si po u përgjigjet qeveria kërkesave aktualisht. Por, unë jam diplomat, dhe kjo do të thotë se unë gjithmonë kërkoj rrugë pozitive përpara. Më duhet të besoj se mund të gjejmë një rrugë të përbashkët përpara, që është në

interes të të gjithëve, dhe në interes të paqes dhe sigurisë”. Ai ka theksuar se ka pasur kontakte të vazhdueshme me Qeverinë e Kosovës, por ka shtuar se “nuk mund të konfirmoj se qeveria ka ndërmarrë veprimet që ia kemi kërkuar”.

Hovenieri ka deklaruar se nga këndvështrimi i ShBA-së, Qeveria e Kosovës ka të drejtë për zbatimin e planit të saj por, sipas tij, ekzistojnë “shqetësime reale për mënyrën e zbatimit”.

Qeveria e Kosovës më 1 nëntor nisi zbatimin e planit të saj për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme, me gjithë insistimin e mëhershëm të komunitetit ndërkombëtar që ta shtyjë zbatimin e tij.

Janë rreth 9 000 makina me targa të tilla që qarkullojnë në veriun e Kosovës - të banuar me shumicë serbe - që nga paslufta më 1999. Qeveria e Kosovës kërkon që ato të zëvendësohen me targa RKS, apo Republika e Kosovës. Plani i saj parashihet të zbatohet në tri faza: e para, qortimi i shoferëve; e dyta, dënimi i shoferëve me 150 euro gjobë; e treta, shpërndarja e targave provuese.

Shumica e serbëve në veri, të mbështetur nga Beogradi zyrtar, e

kundërshtojnë planin, duke insistuar në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Në shenjë kundërshtimi ndaj zbatimit të tij, serbët e veriut kanë dhënë dorëheqje nga institucionet e Kosovës. Ata kanë thënë se nuk do të rikthehen nëse Qeveria e Kosovës nuk e themelon Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe nuk e tërheq vendimin për reregjistrimin e makinave. “Të gjithë jemi të shqetësuar për situatën në veri”, sepse ajo ka “potencial të eskalojë”, ka deklaruar ambasadori Hovenier.

I pyetur se si i komenton shkrimet e disa medieeve, se ministres së Drejtësisë në Kosovë, Albulena Haxhiut, i është refuzuar viza për një vizitë zyrtare në ShBA, Hovenieri ka thënë se “nuk sheh ndonjë rrethanë” për diçka të tillë. Megjithatë, shtoi ai, Kosova tani “është në krizë”. “Jemi shumë të fokusuar në këtë krizë. Ne besojmë se kjo qeveri është shumë e fokusuar në këtë krizë. Dhe kështu, kjo nuk është domosdo koha më e përshtatshme që ministrat të udhëtojnë në ShBA për takime zyrtare, marrë parasysh krizat që duhet të trajtohen këtu. Këtë po

ua komunikojmë zyrtarëve të ndryshëm në qeveri”, ka thënë Hovenier.

Ambasadori amerikan, gjithashtu, tha se Qeveria e Kosovës duhet të bisedojë me komunitetin serb, duke shfaqur shpresën se përfaqësuesit e tij do të kthehen në institucionet e Kosovës. “Shpresojmë që kjo gjë të jetë e përkohshme”, ka thënë Hovenieri, duke i komentuar dorëheqjet e zyrtarëve serbë. “Ne besojmë se tërheqja e serbëve nga institucionet e Kosovës nuk është zgjidhje për mosmarrëveshjet aktuale”, shtoi ai.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka akuzuar më 7 nëntor presidentin serb Aleksandër Vuçiq për destabilizimin e situatës në veri të Kosovës. Ai ka thënë se kjo po bëhet për shkak të, siç është shprehur, refuzimit të planit franko-gjerman nga pala serbe. Ky plan, siç është raportuar më herët, parasheh zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis Kosovës dhe Serbisë. Sipas Kurtit, Vuçiqi është duke i përdorur pjesëtarët e strukturave ilegale serbe në veri të Kosovës për destabilizim të situatës. Për Kosovën, sipas Kurtit, plani franko-gjerman është “hap në drejtimin e duhur”.

Të premten në Paris Borrelli takohet ndaras me Kurtin dhe Vuçiqin



PRISHTINË, 10 NËNTOR - Shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, pritet të zhvillojë takime të ndara me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Këtë e ka konfirmuar zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, nëpërmjet një postimi në "Twitter".

Takimet do të zhvillohen më 11

nëntor në Paris, ku liderët po marrin pjesë në Forumin e Paqes. Sipas Stanos, qëllimi i takimit është të ndihmojë në zbutjen e përshkallëzimit të situatës, qetësimin e tensioneve aktuale dhe avancimin e dialogut të Brukselit.

Me Kurtin dhe Vuçiqin pritet të takohet më 10 tetor edhe presidenti francez Emmanuel

Macron.

Të mërkurën kryeministri Kurti paralajmëroi mundësinë e një takimi trepalësh me Vuçiqin. Takimi eventual ndërmjet tyre pason pas krizës në veri, pasi pjesëtarët e komunitetit serb u larguan nga institucionet e Kosovës.

Qeveria e Kosovës nisi më 1 nëntor ta zbatojë planin e saj për

reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme, me gjithë insistimin e mëhershëm të komunitetit ndërkombëtar që ta shtyjë këtë plan.

Kosova kërkon që ato të zëvendësohen me targa RKS, apo Republika e Kosovës. Plani i saj parashihet të zbatohet në tri faza: e para, qortimi i shoferëve; e dyta, dënimi i shoferëve me 150 euro

gjobë; e treta, shpërndarja e targave provuese.

Shumica e serbëve në veri, të mbështetur nga Beogradi zyrtar, e kundërshtojnë planin, duke insistuar në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Në shenjë kundërshtimi ndaj zbatimit të tij, serbët e veriut kanë dhënë dorëheqje nga institucionet e Kosovës.

Kryeprokurori i Shtetit viziton Prokurorinë Themelore në Mitrovicë



PRISHTINË, 10 NËNTOR - Ushtruesi i detyrës i kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, i shoqëruar nga anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Armend Zenelaj, u. d. drejtori i Sekretariatit të KPK-së, Valdrin Krasniqi dhe zyrtarë të tjerë, ka vizituar Prokurorinë Themelore në Mitrovicë pas situatës së

krijuar me ofrimin e dorëheqjeve të prokurorëve dhe stafit administrativ nga komuniteti serb.

Kryeprokurori Kelmendi u njoftua për së afërmi nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Ismet Ujkani, për veprimet e ndërmarra nga ai, për gjendjen e krijuar, për

sfidat dhe nevojat e kësaj prokurorie për përballimin dhe tejkalimin e vështirësive që janë paraqitur pas situatës së fundit, ku së bashku diskutuan për gjetjen e modaliteteve për vazhdimin dhe menaxhimin sa më të mirë të punës, veçmas të trajtimit të lëndëve me natyrë urgjente.

Me këtë rast, u.d. kryeprokurori i

Shtetit shqyrtoi të gjitha mundësitë për mbështetjen dhe ofrimin e ndihmës për këtë prokurori në bazë të kompetencave të tij, duke përfshirë edhe transferimin e jashtëzakonshëm të prokurorëve nga prokuroritë e tjera për mbarëvajtjen sa më efektive të punës në funksion të sundimit të

ligjit. Ndërsa përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës u zotuan se do t'i ndërmarrin të gjitha masat për sigurimin e kushteve të nevojshme me qëllim që Prokuroria Themelore në Mitrovicë të funksionojë sa më mirë dhe të mos krijohet asnjë zbrastëti në procesin e punës.

Totaj në Turqi viziton shumë projekte në zhvillim në sferat e arsimit dhe kulturës

PRIZREN, 10 NËNTOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me kryetarin e komunës së Edirnes në Turqi, Recep Gurkan, ka vizituar punëtorinë e grave në "Shtëpinë e Purpurt" dhe "Qendrën e Artizanatit dhe

Prodhimit e Zhvillimit të Kulturës Turke" në Edirne. Gurkan ka sqaruar se janë duke punuar që produktet artizanale të këtyre grave të jenë pjesë edhe e tregut ndërkombëtar. Një projekt i tillë pretendohet të realizohet edhe në komunën

e Prizrenit.

Totaj gjatë vizitës në Edirne të Turqisë ka vizituar edhe shumë projekte në zhvillim në sferat e arsimit, ruajtjes së mjedisit dhe kulturës, me ç'rast është diskutuar për realizimin e projekteve të përbashkëta në të ardhmen.



Shpërndahen kontratat për 50 fermerë përfitues të serrave në Podujevë

PODUJEVË, 10 NËNTOR - Në hapësirat e Kuvendit Komunal të Podujevës janë shpërndarë kontratat për 50 fermerë përfitues nga projekti "Ndarja e serrave për kultivim për familjet me kushte të rënda ekonomike". Në ceremoninë e shpërndarjes së kontratave mori pjesë nënkryetarja e komunës Marigona Lahu, e cila në emër të komunës së Podujevës i uroj fermerët përfitues, duke u dëshiruar punë të mbarë e duke i siguruar se komuna do të vazhdojë me projekte të tilla edhe vitin e ardhshëm, me qëllim të mbështetjes për

fermerët e vyer dhe përmirësuar mirëqenien e qytetarëve.

Ky projekt është bashkëfinancim në mes të komunës së Podujevës dhe organizatës "Qatar Charity", ku komuna participon me 30 përqind e vlerës së projektit, ndërsa organizata nga Katari 70 përqind. Montimi i serrave do të bëhet nga java e ardhshme. Nënkryetarja Lahu falënderoi edhe organizatën nga Katari për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me komunën si dhe u zotua për bashkëpunim të mëtutjeshëm edhe në sfera të tjera.

Komuna e Skenderajt bën shpërndarjen e fidanëve të kumbullës dhe arrës

SKENDERAJ, 10 NËNTOR - Në Komunën e Skenderajt është bërë shpërndarja e fidanëve të kumbullës dhe arrës. Me këtë rast, 32 pemëtarë kanë përfituar fidanë të kumbullës dhe 10 të arrës, në pakon e cila, përveç fidanëve, përfshin sistemin e ujitjes dhe gërshërët elektrikë për krasitje. Kryetari i komunës, Fadil Nura, i pranishëm në ceremoninë e mbështetjes së pemëtarëve, duke i përgëzuar për përfitim nga thirrja publike, ka thënë se qeverisja e tij do të vijojë ta mbështesë bujqësinë me të

gjithë sektorët e saj.

Edhe drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Behxhet Maliqi, ka uruar pemëtarët përfitues, duke thënë se drejtoria që udhëheq ai do të ketë edhe thirrje të tjera publike në kuadër të mbështetjes dhe ndihmës së bujqve e fermerëve të komunës sonë.

Shpërndarja e fidanëve vjen pas pesë fazave të mbështetjes së bujqve me pajisje dhe makina bujqësore, që dëshmon përkushtimin e qeverisë Nura për zhvillim të bujqësisë.



Nisin punimet për ndërtimin e urës në fshatin Carrallukë të Malishevës

MALISHEVË, 10 NËNTOR - Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në vendbanimet e komunës së Malishevës, në fshatin Carrallukë ka filluar ndërtimi i urës në drejtim të shkollës.

Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka thënë se "ndërtimi i kësaj ure është pjesë e projekteve dhe investimeve të qeverisë lokale

si dhe i planifikimeve komunale për këtë vit, kështu që gradualisht jemi duke i përmbushur kërkesat dhe nevojat e banorëve të Carrallukës në infrastrukturën rrugore, sikur edhe në të gjitha vendbanimet e tjera". Po ashtu, kryetari Kastrati i ka uruar banorët për projektin e urës që po realizohet në fshatin e tyre. Ndërsa drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Avdi Morina, ka

thënë se ky projekt do të realizohet brenda dinamikës së planifikuar në afatizimin kohor. "Kjo urë tash e tutje do t'i evitojë dëmet e vendbanimeve përreth në rast të vërshimeve nga shirat", ka thënë Morina.

Në fillimin e punimeve të urës ishin të pranishëm këshilltarja e Kuvendit Komunal, Gentianë Hoti dhe qytetarë e veprimtarë të fshatit Carrallukë.



Deliu: Besoj se duhet ta kemi datën e shumëpritur për vizat

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerta Deliu-Kodra, ka ripërsëritur qëndrimin e saj për liberalizimin e vizave,

duke shtuar se kjo duhet të ndodhë për qytetarët e Kosovës. “Në Këshillin e Bashkimit Evropian sot pritet të mbledhet grupi punues për vizat, ku do të

diskutohet për procesin e heqjes së vizave për shtetasit e Kosovës. Me shpresë që padrejtësia e madhe ndaj qytetarëve të Kosovës dhe kushtëzimet e reja

po marrin fund, besoj se përfundimisht dhe do të duhej ta kemi datën e shumëpritur për vizat”, ka shkruar ajo në “Facebook”.



IKD-ja: Masat për parandalimin e dhunës kundër grave janë represive

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, ka publikuar analizën “Masat represive për mbrojtjen e grave”, i cili raport është rezultat i analizës që IKD i ka bërë Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Penal dhe Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale.

Qeveria e Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, ka iniciuar në Kuvend Projektligjin për Ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Këto projektligje, ndër të tjera, kanë për synim përcaktimin e dispozitave për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit për luftimin e veprave penale të dhunimit, sulmit seksual dhe dhunës në familje.

Përkundër qëllimit tejet legjitim për t'i luftuar këto dukuri serioze kriminale, IKD-ja gjen se Ministria e Drejtësisë dhe qeveria nuk kanë ndjekur rrugën adekuate për ta bërë këtë, pasi IKD-ja gjen se të këto dy projektligje shoqërohen me shkelje të Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Po ashtu, IKD-ja gjen se këto projektligje janë në kundërshtim me disa prej parimeve bazë të drejtësisë penale. Në disa raste IKD-ja ka gjetur se këto dispozita janë në kundërshtim edhe me interesat e viktimave, të cilat interesa synohen të avancohen përmes këtyre projektligjeve. Përcaktimi i Projektligjit të Procedurës Penale, se në të



gjitha rastet e dhunimit dhe dhunës në familje duhet të caktohet paraburgimi nga gjykata, është në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo krijon potencial të lartë të keqpërdorimit përmes raportimeve të pavërteta, madje edhe ndaj grave, mbrojtja e të cilave synohet përmes këtyre projektligjeve. Projektligjet kanë përcaktuar se në rastet e dhunimit dhe dhunës në familje aplikohen dënime plotësuese të cilat nuk janë në harmoni me synimet e dënimeve plotësuese. Përmes

dënimeve plotësuese, si ndalimi i blerjes në ankande, aplikimi si investitor strategjik, punësimi në sektorin publik dhe drejtimi i automjetit, projektligjet kanë ndjekur një qasje represive ndaj të dënuarve për këto raste, e cila qasje nuk njihet në të drejtën penale bashkëkohore. Kjo qasje represive është në kundërshtim me qëllimet e dënimit. Përmes këtyre dënimeve rritet potenciali për recidivizëm, potencial ky i kundërt me qëllimet e dënimit. IKD-ja gjen se publikimi i aktgjyqimeve në rastet e dhunës në familje krijon kundërefekt për viktimat e dhunës në familje. Veçanërisht

në një shoqëri të vogël si Kosova, viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët lehtësisht mund të identifikohen. Shkelja e konfidencialitetit në këtë rast shkon në kundërshtim me interesat e viktimave të dhunës në familje. Po ashtu, si dispozitë e cila paraqet dëmtim të interesave të viktimave të dhunës në familje është edhe shkurtimi i afateve të hetimit të këtyre rasteve. Sa i përket dhunës ndaj grave në jetën publike, IKD-ja ka gjetur se kjo dispozitë është në kundërshtim me barazinë para ligjit për shkak se gjinia e viktimës konsiderohet element i veprës penale. Ky inkriminim mund të krijojë

probleme në ushtrimin e të drejtës për të protestuar në raste të caktuara me interes publik, përderisa nuk është e përcaktuar se çfarë nënkuptohet me “dhunë fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike”.

Duhet theksuar faktin se inkriminimi i kësaj vepre penale nuk është çështje e njohur në vendet evropiane. Ky lloj inkriminimi gjenezën e ka në shtetet e Amerikës Latine, ku Bolivia ka qenë shteti i parë që në vitin 2012 e ka inkriminuar këtë vepër penale. Edhe konteksti i këtyre shteteve është i ndryshëm nga rasti i Kosovës dhe kështu nuk legjitimohet ky lloj inkriminimi.

Rivarrosen dhjetë dëshmorë të UÇK-së në Skenderaj

SKENDERAJ, 10 NËNTOR - Të enjten në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë është bërë rivarrimi i dhjetë dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Dëshmorët e kombit Driton Ibrahim, Kadri Mehmeti,

Xhevxhet Maliqi, Ejup Behrami, Sokol Rama, Fadil Seferi, Fadil Selmani, Gëzim Ferizi, Afrim Gashi, Ilmi Aliu, nga sot u bashkuan përfundimisht me shokët e tyre dëshmorë, që nuk i ndau as jeta as vdekja, për të pushuar të qetë

në këtë pjesë të tokës së Kosovës, që aq shumë e deshën”, ka thënë nënkryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, duke shtruar se sot është ditë e rëndë për Drenicën, pasi këta dëshmorë kanë dhënë jetën për lirinë e Kosovës.




KEDS-i: Ngrohja me rrymë ua rrit faturën për 70 për qind

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë (KEDS) ka theksuar se derisa çmimi i energjisë elektrike po rritet dita-ditës në tregun ndërkombëtar si përgjigje ndaj klimës politike dhe asaj energjetike, është e domosdoshme që konsumatorët tanë të menaxhojnë shpenzimet enorme dhe përdorimin e energjisë në mënyrë sa më eficiente të mundshme. “Por, a e dini se ku shpenzojnë më së shumti konsumatorët

tanë energji elektrike gjatë dimrit? Ekspertët e KEDS thonë se 70 për qind e faturës së përgjithshme të energjisë elektrike faturohet vetëm nga ngrohja. Duke ditur se ngrohja me energji nënkupton edhe fatura të larta, bashkë me të edhe ngarkesë e sistemit elektroenergjetik, KEDS udhëzon që të shmangët ngrohja me energji elektrike nëse konsumatorët tanë gjejnë alternativa tjera”, ka njoftuar KEDS.

Sipas kësaj kompanie, kështu mund të kurseni energjinë

elektrike për veten dhe ta shpërndani atë tek të gjithë konsumatorët. “Shmangeni tërësisht ngrohjen me energji elektrike nëse keni alternativa tjera të ngrohjes; Uleni termostatit e ngrohjes në 19 °C; Ndaleni për së paku dy orë ngrohjen me energji elektrike gjatë ditës; Ndaleni ngrohjen në ambientet ku nuk qëndroni gjatë (dhomë të gjumit, korridore, banjo). Këto udhëzime përkohë me udhëzimet që shtetet evropiane ua kanë transmetuar qytetarëve të tyre për shkak të krizës së



madhe energjetike që e ka luftës në Ukrainë”, ka njoftuar kapluar Evropën si rezultat i KEDS.

Ndahen 15 milionë euro për Rezervën Shtetërore, origjina e produkteve kryesisht nga Kosova

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Ministri e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se për vitin 2023 janë ndarë 15 milionë euro për Rezervën Shtetërore.

Hajdari duke iu përgjigjur pyetjeve në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të enjten ka theksuar se origjina e produkteve është kryesisht nga vendi ynë. “Ligji i Rezervës Shtetërore obligon Departamentin e Rezervës sipas planit trevjeçar 2021-2023, që është miratuar në Qeveri dhe sipas kërkesës prej 7.5 milionë euro që kishte ky plan, ne e kemi miratuar kërkesën buxhetore nga 7.5 milionë euro plus 2.5 milionë euro, gjithsej 10 milionë euro për vitin 2022 dhe 15 milionë euro për vitin 2023. Kryesisht të gjithë artikujt që janë blerë janë kryesisht produktet e grurit, sheqeri, vaji dhe nafta. Origjina e produkteve ndryshon, por kryesisht janë nga Kosova. Një pjesë e grurit është nga Franca dhe Ukraina”, ka thënë Hajdari.

Sipas saj, të gjithë operatorët i kanë kryer obligimet lidhur me sjelljen e rezervave shtetërore. “Kemi nënshkruar më shumë se një kontratë gjatë vitit 2022



dhe i kemi pranuar të gjitha furnizimet e rezervave shtetërore. Një kontratë të re e kemi më proces të negocimit,

ndërsa një tjetër është në proces të sjelljes së një pjesë të kontraktuar”, u shpreh ministri Hajdari, duke shtuar

se të gjithë operatorët i kanë kryer obligimet, kështu që, sipas saj, sasitë e deponuara të rezervave janë vendosur në

pjesë të ndryshme të vendit me sigurinë e operatorëve ekonomikë, sipas kontratave të nënshkruara.

Hoti thotë se ekonomisë së Kosovës i mungojnë rreth 500 milionë euro

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka theksuar se sot ekonomisë së vendit i mungojnë 500 milionë euro.

Hoti u shpreh se bilanci bankar është dyfish më shumë, ndërsa investimet kapitale janë më të ulëta në 20 vitet e fundit. “Bilanci bankar dyfishi më shumë se sa që është i nevojshëm dhe investime kapitale më të ulëta ndonjëherë që ka parë Kosova në 20 vite edhe në kohën e pandemisë është punuar më shumë, dhe sipas vlerësimeve të mija sot ekonomisë së Kosovës i

mungojnë rreth 500 milionë euro për shkak se ju as nuk po ua leni qytetarëve mjetet dhe as nuk po i shpenzoni vetë”, ka thënë Hoti.

Më pas ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati e quajti dezinformatë atë që e tha deputeti Hoti.

Sipas tij, për shkak të inflacionit është ngadalësuar ritmi i investimeve kapitale. “Me dezinformatën që sapo e thatë që mungojnë para në ekonomi gjë që është e pavërtetë, krahasuar me vitin e kaluar bilanci bankar është më i ulët edhe në raportin shtatë mujor

edhe në raportin aktual sipas ditës së djeshme. Pra bilanci bankar është më i ulët që i bie që më shumë para ka hyrë në ekonomi dhe nëse e shikon kategoritë tjera të shpenzimeve sepse po manipulohet me shifrën e investimeve kapitale për shkak të inflacionit dhe për shkak të rritjes së çmimeve që i kanë detyruar punëkryesitë nuk ka të bëjë me bllokada prej qeverisë por për shkak se punëkryesit kanë hezitur t’i kryejnë punët kemi ngadalësim të ritmit të investimit kapitale edhe në nivel qendror dhe lokal”, ka thënë Murati.



A çon retorika politike e dhunshme në një dhunë të vërtetë?



Nga Joe PIERRE

Muajin e kaluar, një person i panjohur hyri në shtëpinë e kryetares së Kongresit të SHBA-së, Nensi Pelozit, me synimin për ta marrë peng dhe për t'i "thyer gjunjët". Kur zbuloi se ajo nuk ndodhej në shtëpi, ai u përball i zemëruar me bashkëshortin e saj Pol Pelozin.

Kur policia mbërriti në vendngjarje, sulmuesi e goditi Pelozin në kokë me një çekiç, duke e rrëzuar atë në tokë pa ndjenja. Pol u dërgua me urgjencë në spital me një frakturë në kafkë. Në vend se ta denonconin sulmin apo të solidarizoheshin me viktimën e këtij sulmi, disa politikanë të së djathtës e shpërfillën rëndësinë e saj. Kandidatja për guvernatore në shtetin e Arizonës, Kari Lake, shfrytëzoi rastin për të mbrojtur mbajtjen e armëve për të mbrojtur fëmijët në shkollë.

Në Teksas, Partia Republikane e Qarkut Kolin, postoi më mënyrë një foto të një çekiçi. Edhe djali i Donald Trump, postoi në Twitter foton e një çekiçi së bashku me një palë të brendshme burrash, një referencë ndaj një teorie të rreme konspirative, sipas së cilës sulmuesi i Pelozit ishte një homoseksual që prostituonte me mbishkrimin "Kam gati kostumin që veshi Pol Pelozit për Halloween!".

Edhe kongresmeni republikan nga Luiziana, Klej Higin, postoi në Twitter një foto të montuar të Nensi Pelozit me një syrin nga sytë e nxirë me mbishkrimin: "Momenti kur e

kupton që i riu nudist dhe homoseksual, ishte arsyeja pse bashkëshorti yt nuk mori në mbledhjen e fondeve".

Pasi Hilari Klinton e dënoi sulmin dhe i tërhoqi vëmendjen atyre që pajtohen me teoritë e QAnon dhe gjuhën e urrejtjes së ekstremit të djathtë, Elon Musk u përgjig duke ripostuar artikullin e gazetës tabloide, që nxiti teorinë e konspiracionit se sulmuesi i Pelozit ishte i dashuri i tij homoseksual, me komentin: "Ka shumë të ngjarë që kjo histori të ketë gjëra të tjera interesante...".

Ndërkohë, demokratë të tjerë nxituan të tërhoqnin vëmendjen për dështimin e republikanëve për ta denoncuar këtë akt të dhunës politike. Kongresmenja e Nju Jorkut, Alesandra Okasio-Kortez, shkroi në Tëitter: "Vitin e kaluar, një kongresmen republikan publikoi në rrjetet e tij sociale një përshkrim të vetes duke më vlarë. Dje një burrë që ndan retorikën e tij ekstremiste tentoi të vriste kryeparlamentaren dhe bashkëshortin e saj. Çfarë ka thënë Mçarthy? Asgjë".

Tweet-i i Okazio-Kortez për "një kongresmen republikan" i referohej postimit të një videoje në vitin 2021 nga republikani Pol Gosar, që e përshkruante veten si një personazh i animuar, që e vriste kongresmenen demokrate. Edhe pse Gosar u thirr të jepte shpjegime në Kongres për imazhet e dhunshme, ai e cilësoi atë si një fushatë "për të vërtetën", dhe se "të gjithë duhet të qetësohen".

Për shumë liberalë, dështimi për të

denoncuar dhunën politike ndaj Pelozit – një figurë politike shumë e urreyer nga e djathta amerikane – ka qenë shumë i dukshëm, dhe është në kontrast të plotë me shprehjet e vetë Pelosit të simpatisë për kongresmenin republikan të Luizianës, Stiv Skalise, pasi u qëllua nga një person gjatë një ndeshje bejsbolli në vitin 2017.

Në të vërtetë, në politikën amerikane duket se ka hyrë një lloj standardi i dyfishtë. Ndërsa presidenti Obama u kritikua shumë për veshjen e një kostumi ngjyrë kafe në vitin 2014, dhe Klinton u përball me një reagim të ashpër për gafën e saj mbi "mjeranët republikanë" gjatë fushatës së saj të vitit 2016, retorika e dhunshme politike – që vjen kryesisht nga e djathta – shpesh ose banalizohet ose shpërfillet si një metaforë e padëmshme.

Mohimi i faktit – pra pretendimi se ngjarja nuk po ndodh – ka qenë gjithashtu një taktikë e zakonshme. Moderatorja e FOX News, Laura Ingraham, kundërshtoi së fundmi idenë se e djathta politike është përgjegjëse për gjuhën e dhunshme të urrejtjes, duke pyetur: "Cili zyrtar ose kandidat republikan ka falur ndonjëherë apo inkurajuar ndonjë lloj sulm të dhunshëm? A mund të filloni t'i përmendni ata? Se unë nuk mundem".

Në kundërpërgjigje, "The Daily Show" bëri një përmbledhje të videoeve ku kongresmenin republikan Madison Koutorn inkurajon një turmë mbështetësis të "kërcënojë

butësisht" dhe "të përndjekë" ligjvënësit demokratë. Ndërkohë kongresmeni i Alabamas Mo Bruks deklaroi se "sot është dita kur patriotët amerikanë do të nisin të liçojnë politikanët".

Kongresmeni nga Florida Met Getz deklaroi në një rast se "kënetat politike në Uashington nuk do të thahet vërtetë, derisa të varrim me gozhdë në mur lëkurën e aligatorëve". Kongresmenia e Xhorxhias Marjori Tejlror deklaroi para një turme se "Nansi Pelosi është fajtorë për tradhtinë", teksa u kujtoi atyre se "tradhtia është një krim që dënohet me vdekje".

Dhe kandidatët republikanë pozojnë me armë në reklamat e fushatës elektorale, duke i ftuar kundërshtarët demokratë në duele me arme të stilit të Perëndimit të Egër. Përballë faktit që retorika e dhunshme politike në të djathtë është bërë një realitet shumë i zakonshëm, ç'mund të thuhet mbi pretendimin se kjo lloj retorike është vetëm një 'metaforë e padëmshme'?

Por kjo nuk është e vërtetë. Për më shumë se një dekadë, profesori i shkencave politike të Universitetit Shtetëror të Luizianës, Nathan Kalmo, na ka paralajmëruar se retorika e dhunshme politike – edhe kur është metaforike si në rastin kur flasim për "luftërat" dhe "betejat" politike – nuk mund të mos nxisë më tej zemërimin dhe polarizimin politik.

Por ashtu kjo lloj gjuhe i hap rrugën agresionit dhe dhunës reale. Lidhja e dukshme midis retorikës së dhunshme politike dhe potencialit

për dhunë të vërtetë është e pamundur të injorohet. Me rritjen e retorikës së dhunshme, është shtuar edhe mbështetja për dhunën politike.

Ndërsa sondazhet e vitit 2010 zbuluan se vetëm rreth 16 për qind e amerikanëve e pranonin dhunën politike në rrethana të caktuara, kjo shifër u rrit në 23 për qind në vitin 2015, dhe arriti kulmin në 34-40 për qind midis viteve 2020 dhe 2022.

Duke pasur parasysh këto, nuk është e habitshme që në një akt të paprecedentë në historinë amerikane, një turmë e zemëruar sulmoi Kapitolin në vitin 2021 duke kërkuar të kapnin Pelozin dhe udhëheqësit e tjerë politikë ndërsa brohoritnin "Vareni Majk Pens!". Në bashkëpunim me profesoren e shkencave politike të Universitetit Merilend, Liliana Mejzën, Kalmo ka zbuluar se dhuna aktuale politike, parashikohet më së miri në një nivel individual me pasjen e një "personaliteti agresiv" së bashku me "identifikimin e fortë me një parti" dhe "shkëputjen partiake morale".

Kjo do të thotë t'i shohësh anëtarët e partisë kundërshtarë si "të këqij, më pak sesa njerëzorë, dhe si një kërcënim serioz për kombin". Kjo është pikërisht ajo që bën retorika politike e dhunshme. Ajo e dehumanizon atë që mbështet kahun e kundërt politik, duke i portretizuar ata si armiq të këqij kundër të cilëve duhet luftuar, jo vetëm në kutitë e votimit, por edhe menjë dhunë të vërtetë nëse është e nevojshme.

"Psychology Today" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Llapi shkatërroi Ballkanin, s'ka fitues në derbin e Anamoravës

Skuadra e Llapit ka mposhtur kampionin e Kosovës, Ballkanin, me rezultat bindës. Ndërsa derbi në Anamoravë, në mes të Gjilanit dhe Dritës, ka përfunduar pa fitues

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Java e 16 e Superligës së Kosovës në futboll ka përfunduar me dy ndeshjet që janë zhvilluar të enjten. Skuadra e Llapit e ka shkatërruar kampionin në fuqi, Ballkanin, me rezultat 4-1. Llapi tregoi dominim që nga pjesa e parë e ndeshjes, pas e mbylli këtë pjesë me dy gola epërsi. Fernandinho dhe Francisco Rivera realizuan golat për skuadrën e drejtuar nga Tahir Batatina. Në pjesën e dytë Ballkani tentoi të krijonte më

shumë në kërkim të rikthimit të rezultatit, por përsëri mysafirët shënuan edhe dy gola të tjerë për një fitore të thellë, ndërsa Ballkani vetëm një në fund të ndeshjes. Realizues ishin për Llapin, Rivera (77') dhe Gerhard Porgni (90'), kurse për vendasit golin e nderit e realizoi mbrojtësi Lumbardh Dellova në minutat shtesë të ndeshjes. Pas kësaj fitoreje, Ballkani mbetet i dyti me 27 pikë, kurse Llapi ngrehet në pozitën e pestë me 19 pikë. Në ndeshjen tjetër derbi të Anamoravës, Gjilani dhe Drita i kanë ndarë pikët. Për Gjilanin



shënuan Baton Zabërxha, kurse për "Intelektualët" Almir Ajzeraj. Drita vazhdon të jetë lidere me 32 pikë, kurse Gjilani ngrehet në vendin e tretë me 24 pikë. Të mërkurën u zhvilluan tri

ndeshjet e tjera të javës së 16, ku FC Prishtina pësoi humbje në përballje me Malishevën (2-1). Fitore shënuan Dukagjini dhe Trepça '89 në përballje me Drenicën, përkatësisht Ferizajn.

SUPERLIGA - Java 16

Ballkani - Llapi	1-4
Gjilani - Drita	1-1
Malisheva - Prishtina	2-1
Ferizaj - Trepça '89	2-3
Drenica - Dukagjini	0-1

Tabela

		Pikë
1. Drita	16	32
2. Ballkani	13	27
3. Gjilani	16	24
4. Prishtina	15	23
5. Llapi	15	19
6. Malisheva	15	18
7. Dukagjini	16	18
8. Trepça '89	18	18
9. Drenica	16	17
10. Ferizaj	16	12

Klea Verri, MVP e javës së parë në Ligën Unike

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Xhiroja e parë e Ligës Unike te femrat u zhvillua në mesjavë, ku tri skuadrat nga Shqipëria fituan ndaj atyre të Kosovës. Tirana fitoi derbin në mes të kryeqyteteve ndaj Prishtinës, ku u dallua Klea Verri e vendasve me 32 pikë, dhjetë kërcime e pesë asistime, duke e pasur indeksin e ndeshjes 37. Verri është pjesë e kombëtares shqiptare dhe një nga lojtaret më të dalluara në Superligën

Shqiptare nga lojtaret vendore. Kjo është hera e parë që zgjedhet MVP. Ndeshje të jashtëzakonshme bëri Sarah Mgbeike e Prishtinës, por që mundi ta ndihmojë skuadrën e saj të shënojë fitore. Mgbeike e mbylli ndeshjen me 27 pikë e 21 kërcime, si dhe gjashtë asistime e tre topa të vjedhur. Pas Superkupës Mbarëkombëtare, Flamurtari mundi sërish Bashkimin, ku u dallua dyshja Samra Omerbasic me 20 pikë,

Top-pesëshja

Klea Verri (Tirana) 32 pikë, 10 kërcime, 5 asistime
Sarah Mgbeike (Prishtina) 27 pikë, 21 kërcime, 6 asistime
Samra Omerbasic (Flamurtari) 20 pikë, 17 kërcime, 2 asistime
Sophia Jacobson (Flamurtari) 22 pikë, 5 kërcime, 7 asistime
Ornela Lalaj (Partizani) 18 pikë, 12 kërcime, 5 asistime

17 kërcime, dy asistime dhe Sophia Jacobson me 22 pikë, pesë kërcime e shtatë asistime. Fitore shënoi edhe skuadra tjetër e Tiranës, Partizani, duke e

mundur në udhëtim kampionen e Kosovës, Penzën, ku u dallua Ornela Lalaj me 18 pikë, 12 kërcime dhe pesë asistime.



Muriqi: E kam përjetuar luftën, kam parë gjëra që s'do të donte t'i shihte asnjë njeri



MALLORCA, 10 NËNTOR - Vedat Muriqi është kthyer prapa në kohë duke e kujtuar fëmijërinë e tij të vështirë. Sulmuesi kosovar, në një intervistë për "Radioestadio", e ka kujtuar edhe kohën e luftës në Kosovë, të cilën e kishte përjetuar. I emocionuar, 28-vjeçari i ka kujtuar ato momente, të cilat nuk

do të donte t'i provojë askush. "E kam përjetuar luftën dhe kam parë gjëra që asnjë njeri nuk do të donte t'i shohë. Kam përjetuar shumë gjëra në jetë", është shprehur prizrenasi në intervistën e tij të gjatë për mediumin spanjoll. Sulmuesi nga Prizreni ka zbuluar

se ka kryer punë të ndryshme kur ishte më i ri dhe kur jetonte në Prizren, vetëm për të fituar. "Para disa vjetësh kam punuar kamerier në Kosovë, kur isha 13 e 14 vjeç. Kam parë shumë gjëra. Punoja në një 'grill house'. Punoja në një skarë dhe kujdesesha për sallatat. Kam filluar të punoj që në

moshën nëntëvjeçare. Kam bërë punë të ndryshme", ka deklaruar Muriqi, i cili po e gëzon një formë të jashtëzakonshme, ndërsa i ka realizuar 8 gola në 12 ndeshje të zhvilluara këtë sezon me Mallorcan. 28-vjeçari realizoi edhe mbrëmë në fitoren ndaj Atletico Madridit.

Pas Zeqirit edhe Januzaj jashtë Botërorit

Bruksel, 10 nëntor - Adnan Januzaj është futbollisti i dytë NGA Kosova që është lënë jashtë listës së Botërorit. Futbollisti nga Istogu, i cili ia kishte kthyer shpinën përfaqësueses së prejardhjes së tij, njëjtë si Andi Zeqiri, nuk është ftuar nga selektori i Belgjikës, Roberto Martinez për Kupën e Botës, e cila do të fillojë të dielën e ardhshme.

Belgjika e publikoi sot listën prej 26 futbollistëve të ftuar për "Katar 2022", ndërsa futbollisti i ri i Sevillas nuk gjendet në të. Ai ka përfunduar në bankinë në këtë fillim sezoni dhe nuk arriti ta tregonte vlerën e tij, ndërsa në Real Sociedad ishte lojtar i rëndësishëm, por që u nda me këtë klub në fund të sezonit të kaluar. Kështu, 27-vjeçari mbeti

pa marrë pjesë në atë që mund të ishte Botërori i tij i fundit, duke pasur parasysh se pas katër vjetësh do të jetë 31-vjeçar dhe do të ketë shumë pak gjasa për të luajtur. Januzaj ishte kërkuar nga Kosova disa vjet më parë, para se ta zgjidhte Belgjikën, me të cilën, megjithatë, mori pjesë në gara të rëndësishme, por pa lënë gjurmë.



'Dardanet' grumbullohen në Koper të Sllovenisë

PRISHTINE, 10 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave të mërkurën ka zbarkuar në Koper sepse më 12 nëntor, me fillim nga ora 15:00, në stadiumin "Bonfika" do ta zhvillojë

ndeshjen miqësore ndaj Sllovenisë. Për këtë ballafaqim selektorja Anneli Andersen ka përzgjedhur 22 futbolliste, prej tyre 10 janë nga kampionati vendor, 10 nga klubet evropiane dhe 2 nga kampionati i

Shqipërisë. Lista e futbollisteve: Lavdije Behramaj, Raimonda Spahiu, Agnesa Gashi, Fatlinda Ramaj, Blerta Smali, Merita Bajrami, Edona Kryeziu, Iliriana Vllasalija, Feride Kastrati, Donjeta Halilaj,

Blerta Shala, Kaltrina Biçkaj, Erëleta Memeti, Viola Avduli, Lumbardha Misini, Erjona Emerllahu, Valentina Metaj, Besjana Reçica, Modesta Uka, Alketa Rama, Rrezona Ramadani dhe Jehona Shala.



Gjermania, Franca dhe Belgjika publikojnë listat për Botëror

BERLIN, 10 NËNTOR - Trajneri i Gjermanisë, Hans-Dieter Flick, ka publikuar listën me 26 futbollistë të ftuar për Kampionatin Botëror. Tronditja që gjermanët morën është se kapiteni i Borussia Dortmundit, Marco Reus, do ta humbasë sërish Botërorin, pasi ka pësuar lëndim në stërvitje. Befasia më e madhe ka qenë talenti 17-vjeçar i Borussia Dortmundit, Youssoufa Moukoko, i cili po kalon nëpër superformë. Befasi është edhe lënia në shtëpi e qendërmbrojtësit Mats Hummels.

Kombëtarja e Francës e ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për Kupën e Botës që mbahet këtë muaj në Katar. Në listën prej 25 lojtarëve të ftuar figurojnë shumë emra të mëdhenj me të cilët Franca synon ta mbrojë titullin e kampionit të botës. Në këtë listë bën pjesë edhe fituesi i "Topit të Artë" për vitin 2022, Karim Benzema, ndërsa mungojnë emra të mëdhenj si Pogba dhe Kante.

Listën për Kupën e Botës e ka publikuar edhe trajneri i Belgjikës, Roberto Martinez. Në listë bëjnë pjesë yjet si Courtois, Hazard, Lukaku, De Bruyne, De



Ketelaere, kurse lojtari me Januzaj, ka mbetur jashtë kësaj origjinë shqiptare, Adnan skuadre.

GJERMANIA

Neuer, Ter Stegen, Trapp, Klotz, Ginter, Gunter, Kehrer, Klostermann, Raum, Rudiger, Schlotterbeck, Sule, Brandt, Adeyemi, Goretzka, Gotze, Fullkrug, Havertz, Hofmann, Gnabry, Gundogan, Moukoko, Kimmich, Musiala, Muller, Sane.

FRANCA

Areola, Loris, Mandanda, L.Hernandez, T.Hernandez, Kimpembe, Konate, Koude, Pavard, Saliba, Upamekano, Varane, Camavinga, Fofana, Guenduzi, Rabio, Çuameni, Veretout, Benzema, Coman, Dembele, Giroud, Grizmann, Mbappe, Nkunku.

BELGJIKA

Casteels, Courtois, Mignolet, Alderweireld, Debast, Faes, Theate, Vertonghen, Carrasco, Castagne, Meunier, Th.Hazard, De Bruyne, Dedoncker, Onana, Tielemans, Vanaken, Witsel, De Ketelaere, Mertens, Trossard, Batshuayi, Openda, Lukaku.

Clippersat fitojnë derbin ndaj lakersave

Los Anxhelos, 10 nëntor - Milwaukee rikthehet te fitorja në kampionat, duke mposhtur me rezultat 136-132 Oklahoma pas fushës, ndeshje e vendosur pas kohës shtesë. Vendimtar për Bucksin në këtë sfidë ishte Carter me 36 pikë e 12 asistime, duke bërë që të mos ndihej mungesa e Antetokounmpos. Për vendasit u dallua Shai me 39 pikë, por që mbetën për statistikë.



Clippersat fituan edhe derbin e dytë sezonal kundër lakersave, këtë herë me shifrat 114-101, duke konfirmuar krizën e skuadrës rivale. Për Clippersin u dallua George me 29 pikë, ndërkohë që 7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Kjo i bëri të pavlefshme 30 pikët e LeBron Jamesit për lakersat. Fiton edhe Bostoni, që mundi me rezultat 128-112 Detroitin falë

30 pikëve të Brownit. Ndërsa Utah Jazzi triumfoi me rezultat 125-119 në fushën e Atlantës, sfidë ku dallimin e bëri Markkaneni me 32 pikë. Rikthehet te fitorja Brooklyn, që mundi 112-85 New Yorkun (Durant 29 pikë, 12 rebounde e 12 asistime), ndërsa 24 pikët e Nikolja Jokiqit i dhanë fitoren Denverit, 122-119 në fushën e Indianas.

SHKURT

Reja: 4-5 lojtarë të Superiores janë gati për Kombëtaren A

Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Edy Reja, pas miqësore së humbur 1-0 ndaj Katarit, ka thënë se pesë futbollistë të kampionatit shqiptar janë gati për të luajtur në ndeshjet zyrtare me fanellën kuqezi. "Ishte një paraqitje e kënaqshme. Jam i kënaqur nga djemtë që punuan mjaft mirë gjatë kësaj periudhe. Meritonim një rezultat më të mirë përballë një skuadre të fortë. Katar ka një ekip të mirë, fizik dhe teknik. Edhe ne ishim në nivelin e duhur. Nuk na u akordua një penallti e pastër, ashtu si edhe në ndeshjen ndaj Arabisë Saudite. Megjithatë, paraqitja e skuadrës ishte e rëndësishme. Më pëlqyen të gjithë lojtarët, por 4-5 elementë do t'i afrojnë në Kombëtaren A", u shpreh Reja.

Alcaraz mbyll sezonin dhe rrezikon ta dorëzojë fronin

Tenisti spanjoll Carlos Alcaraz, numri 1 në botë, nuk do të luajë në ATP Finals, turneu i më të mirëve, që do të nisë javën e ardhshme në Torino (Itali). Në këtë turne luajnë 8 tenistët më të mirë në botë, por do të mungojë pikërisht ai që kryeson renditjen. Alcaraz u dëmtua pak ditë më parë në turneun Masters të Parisit, duke u tërhequr për shkak të një problemi muskolor. Ka qenë vetë 19-vjeçari spanjoll ai që dha lajmin se do të mungojë në Torino (13-20 nëntor), duke shtuar se nuk do të rikthehet më në fushë këtë vit. Çka do të thotë që Alcaraz nuk do të luajë as në Kupën Davis, që zhvillohet më vonë, më 23-27 nëntor në Malaga. Alcaraz e mbyll këtë vit me 57 fitore e 13 humbje në karrierën e tij, ku fitoi në 5 turne, përfshirë edhe US Open. "Për fat të keq, kam një dëmtim në muskulin abdominal dhe kërkon 6 javë kohë rikuperim. Sezoni për mua është i mbyllur, duke mos luajtur dot në Torino", ka thënë Alcaraz, që rrezikon ta dorëzojë kreun e renditjes botërore nëse rivalët më të afërt në renditje fitojnë në Torino.

Reusi sërish humbet Kupën e Botës

Gjermania humbet një kampion në prag të fillimit të Kupës së Botës, Katar 2022. Kapiteni i Borussia Dortmundit, Marco Reus, do të mungojë në Botërorin e Katarit për shkak të një dëmtimi në këmbë. Mesfushori vuan nga një dëmtim në këmbë dhe është i detyruar të mos jetë pjesë e skuadrës gjermane në Katar 2022. Reusi kujtojmë që mungoi edhe në Botërorin e vitit 2014, po për shkak të një dëmtimi. Tekniku Flick pritet që të publikojë gjatë ditës së sotme listën me emrat e 26 lojtarëve që do të shkojnë në Kupën e Botës.

Verstappen: Ky është objektivi im për dy garat e mbetura

Red Bull dhe Max Verstappenin i kanë arritur të gjitha objektivat e këtij sezoni, duke i fituar dy titujt kampionë bote, atë për konstruktorë dhe atë për pilotë. Madje holandezi arriti ta vendosë edhe rekordin e 14 fitoreve sezonale, ndërkohë që kanë mbetur edhe dy gara për t'u zhvilluar, në Brazil dhe Abu Dhabi. Në prag të garës që zhvillohet këtë fundjavë në Interlagos (Brazil), kampioni i botës u shpreh se do të punojë që shoku i tij i skuadrës Sergio Perez të renditet i dyti. "Do të paraqitem në këto dy gara për t'i fituar ato, por edhe për ta ndihmuar shokun tim të skuadrës që të dalë i dyti dhe të jetë nënkampion bote", ka thënë Verstappenin. "Për ne është e rëndësishme që të renditemi në dy vendet e para, ndaj do të luftoj ta ndihmojmë Perez, ashtu sikurse ai më ka ndihmuar mua. Gara sprint do të na shërbejë për të fituar disa pikë, ndaj duhet kujdes që nga e premtja deri të dielën. Ne jemi skuadra më e mirë, ndaj duhet të përfitojmë nga ky fakt", ka deklaruar Verstappenin. "Ne dëshirojmë që Perez të renditet para Leclercut dhe do të përfitojmë nga çdo mundësi. Ndoshta na ndihmon edhe Mercedesi, që në garat e fundit ka qenë më mirë se Ferrari", u shpreh holandezi i Red Bullit.

REZULTATET

Orlando - Dallas	94-87
Charlotte - Portland	95-105
Indiana - Denver	119-122
Atlanta - Utah Jazz	119-125
Boston - Detroit	128-112
Brooklyn - New York	112-85
Toronto - Houston	116-109
Chicago - New Orleans	111-115
Minnesota - Phoenix	117-129
Oklahoma - Milwaukee	132-136
San Antonio - Memphis	122-124
Clippers - Lakers	114-101
Sacramento - Cleveland	127-120



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.1649/1
Datë: 10.11.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/l-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendësdrëjtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPARr-së, shpallë këtë:

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur

I. Titulli i vendit të punës: Drejtor i Qendrës të Kompetencës

Qendra e Kompetencës në Malishevë;

Lloji i Vendit të Punës: Me afat të caktuar, me orar të plotë
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Kategoria Funktionale: Nivel drejtues
Koeficienti: 8.4
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planin zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për përzgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton se paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjisllacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë përgatitje profesionale të profileve përkatëse;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomati e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

II. Titulli i vendit të punës: Zëvendësdrëjtor në Qendrën e Kompetencës në Malisheve

I. Qendra e Kompetencës në Malishevë;

Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë,
Kategoria Funktionale: Nivel drejtues
Koeficienti: 7.8
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Zv. Drejtori , është përgjegjës për marrëdhënie me biznese dhe sigurimin e të hyrave.
- Zv. Drejtori i shkollës, është përgjegjës dhe garanton zhvillimin e aktiviteteve për gjenerimin të të ardhurave;
- Organizimin e kurseve të hapura për punonjësit të ndërmarrjeve të komunitetit lokal;
- Organizim e trajnimeve për zhvillimin dhe aftësimin e të papunëve për tregun e punës në bashkëpunim me zyrën e punësimit;
- Organizimin e panairëve për prezantimin e produkteve të kompanive private dhe publike;
- Dhënie me qira të zyrave me të gjitha pajisjet për bizneset private;;
- Ofrim të shërbimeve këshilluese për ish nxënësit e ndërmarrjeve lokale;
- Bashkëpunon ngushtë me kompanitë private dhe publike;
- Siguron mundësinë e aftësimin dhe punësimit të të gjithë nxënësve në organizata të ndryshme private dhe publike brenda dhe jashtë vendit;
- Motivimin për nxënien për të rritur-personeli dhe prindërit;
- Siguron trajnime dhe aftësime që përshtaten nevojave të tregut të punës;
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Zv. drejtori i shkollës, menaxhon kohën për t'i arritur objektivat organizatave;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të identifikoj problemet e mundshme dhe mundësit;
- Zv. drejtori i shkollës, siguron që hapësirat e shkollës, pajisjet dhe sistemi mbështetës të funksionoj në mënyrë efektive dhe efikase;
- Zv. drejtori i shkollës, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës , përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet e disponueshme financiare dhe asetet për të përmirësuar rezultatet e të nxënit;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar).
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master nga fushat Ekonomis, kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomati e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

Shpallja e Konkursit

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr). Adresa: Rruga “Agim Ramadani” 10000, Prishtinë, kati i tretë duke filluar nga ora 09.00-15.00. Aplikacioni merret dhe dorëzohet në administratën e AAAPARr-së.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes nga dt. 11.11.2022 deri me dt. 25.11.2022

Pas përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve, këtyre kandidatëve do të ju kërkohen kopjet e dokumenteve të vërtetuara nga organi kompetent (diploma dhe kontrata e punës ose vërtetimi i përvojës e punës) nëse ato nuk janë dorëzuar të vërtetuara.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



NPL "HORTIKULTURA" SH.A
PRISHTINË
Data: 11.11.2022

Në bazë të nenit 8 pika 1 dhe 2 e Ligjit të Punës 03/L-212, Rregullores së Brendshme mbi Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Lira të Punës Nr. 1974 të datës: 19.08.2020, Kërkesës së Njesisë së Burimeve Njerëzore me nr. 2976 të datës: 02.11.2022, Aprovimin nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes në takimin e mbajtur me datë: 04.11.2022, si dhe Vendimin e UD Kryeshefit Ekzekutiv me nr. 3046 të datës: 08.11.2022, NPL "Hortikultura" SH.A shpallë konkurs publikë:

1. BASHËPUNËTOR PROFESIONAL PËR QËSHTJE JURIDIKE

Numri i kryesve: 1

Përgatitja shkollore: Fakulteti Juridik ose ndonjë drejtim tjetër përkatës,

- të ketë integritet të lartë moral dhe profesional,
- Shkathtësi të mira kompjuterike,
- Njohje e mirë e gjuhëve zyrtare,

Përvoja e punës: 3 vite

Punët dhe detyrat e punës:

- Siguron mbikqyrjen dhe harmonizimin e veprimtarisë së Ndërmarrjes me legjislacionin dhe standardet në fuqi,
- Ofron këshilla, opinionet dhe rekomandime nga fushëveprimi i Ndërmarrjes sipas kërkesës,
- Siguron respektimin e normave dhe standardeve ligjore në veprimtarinë e Ndërmarrjes,
- Ofron mbështetje ligjore në hartimin e dokumenteve strategjike dhe legjislative nga fushëveprimi i Ndërmarrjes,
- Ofron ndihmë për strukturat organizative të ndërmarrjes në identifikimin e qështjeve që duhet normuar,
- Identifikon qështje për shqyrtim,
- Kryen punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresat e eprorit,
- Për punën e tij i përgjigjet Sekretarit dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

2. SEKRETAR/E TEKNIK/E

Numri i kryesve: 2

Përgatitja shkollore: shkolla e mesme ose Fakulteti Përkatës

Kushtet e posaçme: njohja e punëve me kompjuter si dhe përgatitje tjera profesionale duke marrë për bazë natyrën e punës.

Është e preferueshme edhe njohja e gjuhëve të huaja.

Njohja e punës kompjuter Word-Excel e dëshirueshme.

Përvoja në punë: 1 vit

Punët dhe detyrat e punës:

- bënë pranimin dhe përcjelljen e postës dhe regjistrin në librat interne për dorëzim;
- mbanë evidencën mbi kohën e mungesës së punëtorëve në shërbimet administrative
- palon dhe rregullon evidencën e cila ruhet përherë si arhivë;
- kryen edhe punët e kompjuteristës;
- udhëheqë evidencën e udhëtimeve zyrtare;
- përpilon planin vjetorë dhe mujorë të nevojave të materialit zyrtar dhe materialeve tjera;
- kryen edhe detyra tjera sipas urdhëresës së kryshefit ekzekutiv dhe sekretarit të ndërmarrjes;
- për punën e tij i përgjigjet sekretarit dhe kryshefit ekzekutiv të ndërmarrjes.

3. KURIRI – MBAJTËSI I HIGJENËS

Numri i kryesve: 1

Përgatitja shkollore: Punëtor i kualifikuar ose gjysëm kualifikuar.

Përvoja në punë: 1 vit

Punët dhe detyrat e punës:

- bënë bartjen e drejtëpërdrejtë të postës, dërgesave urgjente dhe bënë pranimin e informatave me shkrim nga partnerët afarist dhe të tjerët;
- kryen punë të llojllojshme jashtë lokaleve të ndërmarrjes;
- mirëmbanë pastertinë e lokalit afarist;
- mirëmbanë inventarin e gjithëmbarshtëm dhe lulet;
- për punën e tij i përgjigjet sekretarit dhe kryshefit ekzekutiv të ndërmarrjes.
- Pastrimin e zyreve dhe të objektit në përgjithësi,
- Pastrimin tualeteve,
- Pastrimin e oborrit dhe hapsirës përreth objektit,
- Kryen edhe punë të tjera të ngjashme nga fushëveprimaria e tij e punës,
- Kryen punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresat e eprorit,
- Për punën e tij i përgjigjet Sekretarit të Ndërmarrjes.

4. KRYEPUNËTOR NË TREGUN E VETURAVE DHE NË TREGUN MOBIL

Numri i kryesve: 1

Përgatitja shkollore: shkolla e mesme, njohja e punës me kompjuter Word dhe Excell

Përvoja e punës: 1 vit

Punët dhe detyrat e punës:

- Kryen punë sipas marrëveshjes me Komunën e Prishtinës për menaxhimin e Tregut të Veturave,
- Përkujdeset për rendin dhe rregullit brenda Tregut të Veturave dhe jashtë tij,
- Përgatit raport javor dhe mujor dhe ja dorëzon Zyrtarit Financiar dhe të Thesarit,
- Bashkëpunon me Komisionin i cili Komision është i caktuar nga Komuna e Prishtinës,
- Qdo ditë pune, punon sipas planit të tij të punës të aprovuar nga ZKF-ja dhe koordinon punët me punëtorët që punojnë në këtë treg,
- Mban përgjegjësi sipas Kontratës së punës për zbatimin e marrëveshjes me Komunën e Prishtinës dhe urdhëresave që vijnë nga ZKF-ja,
- Kryen punë sipas marrëveshjes me Komunën, Vendimeve apo Shkresave nga Komisionet gjegjësisht Komunës,
- Kryen punë sipas planit të biznesit të Ndërmarrjes dhe urdhëresave të Zyrtarit Financiar dhe të Thesarit
- Përkujdeset për rendin dhe rregullin në Tregun Mobil,
- Qdo ditë pune, punon sipas planit të tij të punës të aprovuar nga ZKF-ja dhe koordinon punët me punëtorët që punojnë në këtë treg,
- Mban përgjegjësi sipas Kontratës së punës për zbatimin e marrëveshjes me Komunën e Prishtinës dhe urdhëresave që vijnë nga ZKF-ja,
- Kryen edhe punë të tjera të cilat delegohen nga menaxhmenti,
- Për punën e tij i përgjigjet Zyrtarit Financiar dhe të Thesarit si dhe
- Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes.

5. NDIHMËS INKASANTËT

Numri i kryesve: 2

Përgatitja shkollore: shkolla e mesme njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme.

Përvoja e punës: 1 vit

Punët dhe detyrat e punës:

- bënë inkasimin nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe ngarkohet materialisht me bileta,
- për çdo ditë dorëzon pazarin ditore dhe ngarkohet me bileta dhe shkarkesën,
- plotëson formularin për punën ditore në Laurën e parkut "Germia", tregun e automjeteve si dhe në pozicionet e punës tjera të caktuara nga ndërmarrja mbi kryerjen e pagesave në shërbimet e duhura,
- është i obliguar që çdo parregullsi që vjen eventualisht në bileta duhet ta kthejë te kontabiliteti,
- është i obliguar që në teren të sillt korrekt dhe të mbajë uniformen e caktuar
- për çdo ditë i jep raporte kryepunëtorit për inkasant ose kontabilitetit
- kryen edhe punë të tjera sipas urdhëresës së shefit financiar ose kryepunëtorit të inkasantëve,
- për punën e vet i përgjigjet kryepunëtorit dhe zyrtarit financiar dhe i thesarit të ndërmarrjes.

6. KRYEPUNËTOR NË PRODHIM

Numri i kryesve: 1

Përgatitja shkollore: Shkolla e mesme Profesionale, Gjimnazi, Shkolla Ekonomike etj njohja e punës me kompjuter Word- Excell

Përvoja në punë: 1 vit

Punët dhe detyrat e punës:

- Merr pjesë drejtëpërdrejtë në prodhimin e fidaneve, gjelbërimeve, luleve dhe kujdeset për kultivimin e tyre,
- Përcjellë zhvillimin e të gjitha prodhimeve të reja në serë dhe fidanishte,
- Kujdeset për kryerjen me kohë të punëve në realizimin e rezultateve sa më të volitshme në prodhimtari,
- Kur mendon se prodhimet janë të gatshme për shitje i përcjellë ato me anë të procesit, në mallra të gatshme,
- Kujdeset që punëtorët të jenë vazhdimisht të pranishëm dhe përcjell kontributin dhe kualitetin e punës së tyre,
- Mban evidencën e punëtorëve,
- Kryen punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresat e eprorit,
- Për punën e tij i përgjigjet Koordinatorit të Njesisë Punuese dhe Kryshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes.

7. KRYEPUNËTOR NË VARREZA

Numri kryesve: 1

Përgatitja shkollore: Shkolla e mesme profesionale, gjimnazi, ekonomik etj, si dhe njohja me kompjuter Word-Excell.

Përvoja në punë: 1 vit

Punët dhe detyrat e punës:

- Përcjell punën e hapjes së varreve në përputhshmëri me percaktimet fetare,
- kujdeset rreth punëve dhe gjelbërimit në kuadër të varrezave,
- përgjigjet rreth mirëmbajtjes së varreve sipas kontratave të lidhura,
- përgjigjet në lidhje me përcjelljen e punëve në ngritjen e përmendoreve,
- mbanë evidencën mbi planin detal dhe kartoteken për vendvarrime;
- mbanë evidencën e varreve, përcjell kufomat si dhe përcjell punën e rojtarëve në varreza, bënë mbikqyrjen në lidhje me punën financiare të këtij shërbimi,
- Kryen dhe punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresat e eprorit,
- Për punën e tij i përgjigjet Koordinatorit dhe Kryshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes;

8. ROJTAR OBJEKTI DHE DEPOIST NË PEISAZHIN NATYROR TË MBROJTUR TË "GËRMISË"**Numri i kryesve:** 1**Përgatitja shkollore:** shkolla e mesme, njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme.**Përvoja e punës:** 1 vit**Punët dhe detyrat e punës:**

- Organizon punën në depo,
- Është përgjegjës për pranimin me rregulla të depozitimit, ruajtjen dhe dhënjen e mallit,
- Për tërë mallin në depo përgjigjet materialisht dhe financiarisht,
- Ruan mjetet, materialin dhe tërë prodhimet e gatshme,
- Udhëheqë dokumentacionin për hyrje dhe dalje,
- Angazhohet edhe si roje në njësinë përkatëse,
- Kryen dhe punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresë të eprorit,
- Për punën e tij i përgjigjet Kryepunëtorit dhe Koordinatorit të njësisë së Ndërmarrjes.

9. CICËRON NË PEISAZHIN NATYROR TË MBROJTUR TË "GËRMISË"**Numri i kryesve:** 1**Përgatitja shkollore:** Diplomë universitare, nga fakulteti I menaxhmentit në turizëm, fakulteti i histories, gjeografisë dhe lëmvive përkatëse - njohja e punës me kompjuter Word dhe Excell**Përvoja e punës:** 1 vit**Punët dhe detyrat e punës:**

- Njofton vizitorët për vlerat natyrore të parkut regional "GËRMIA",
- Respektimi dhe zbatimi i ligjit për mbrojtjen e natyrës,
- Pjesëmarrja në përpilimin dhe zbatimin e programeve afatgjata dhe afatmesme të parkut regional "GËRMIA",
- Shoqëron dhe njofton vizitorët për rendësin e të parkut regional "GËRMIA",
- Kryen dhe punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresë të eprorit,
- Për punën e tij i përgjigjet Kryepunëtorit dhe Koordinatorit të njësisë së "GËRMISË".

10. PUNËTORËT FIZIK NË MIRËMBAJTJEN DHE MBROJTJEN E PEISAZHIT NATYROR TË MBROJTUR TË "GËRMISË"**Numri i kryesve:** 4**Përgatitja shkollore:** shkolla fillore ose shkolla e mesme**Përvoja në punë:** E dëshirueshme**Punët dhe detyrat e punës:**

- merr pjesë të drejtëpërdrejtë në të gjitha punët rrethë mbrojtjes së peisazhit natyror të mbrojtur të "Gërmisë",
- kryen të gjitha punët në rregullimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbruara, si dhe mbrojtjen e peisazhit natyror të mbrojtur të "Gërmisë",
- Kryen dhe punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresë të eprorit,
- për punën e tij i përgjigjet kryepunëtorit dhe koordinatorit të njësisë punuese.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Kërkesa për punsim, merret në Arkivën e Ndërmarrjes
- Deklarata nën betim,
- Kopje e letërnjoftimit,
- Çertifikatë nga Gjykata që nuk jani nën hetime,
- Vërtetim mbi përvojën e punës (Trusti pensional)
- Kopje të dokumentacionit mbi përgatitjen shkollore.

Dorëzimi i dokumentacionit për Aplikim bëhet qdo ditë pune, nga ora 08:00 – 15:00, në Arkivën e NPL "HORTIKULTURA" SH.A, Adresa:Rr. "Tahir Zajmi" p.n.(afër Qendrës së Trafikut Urban) Prishtinë Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.



NPL "HORTIKULTURA" a.d

Priština

Datum: 11.11.2022

Na osnovu člana 8 tačka 1 i 2 Zakona o radu 03/L-212, Interni pravilnik o organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1974 od: 19.08.2020, Zahtev Jedinice za kadrove broj 2976 od: 02.11.2022, Saglasnost Privremenog odbora direktora Društva na sednici održanoj: 04.11.2022, kao i Odluku 04.11.2022. UD Izvršni direktor broj 3046 od 08.11.2022.godine, NPL „Hortikultura“ SH.A objavljuje javni konkurs:

1. STRUČNI SARADNIK ZA PRAVNA PITANJA

Broj lidera: 1

Školska priprema: Pravni fakultet ili bilo koji drugi relevantan predmet,

- imaju visok moralni i profesionalni integritet,

- Dobre kompjuterske veštine,

- Dobro poznavanje službenih jezika,

Radno iskustvo: 3 godine

Poslovi i radne obaveze

- Obezbeđuje nadzor i uskladjivanje delatnosti Preduzeća sa zakonima i standardima na snazi,
- na zahtev daje savete, mišljenja i preporuke iz delokruga Preduzeća,
- obezbeđuje poštovanje zakonskih normi i standarda u delatnosti Društva,
- pruža pravnu podršku u izradi strateških i zakonskih dokumenata iz delokruga Preduzeća,
- Pruža pomoć organizacionim strukturama preduzeća u identifikaciji pitanja koja treba standardizovati,
- identifikuje probleme za pregled,
- obavlja i druge poslove po osnovu delatnosti preduzeća i naloga pretpostavljenog,
- Za svoj rad odgovara sekretaru i izvršnom direktoru.

2. TEHNIČKI SEKRETAR

Broj lidera: 2

Obrazovanje: srednja škola ili odgovarajući fakultet

Posebni uslovi: poznavanje rada na računaru kao i druga stručna usavršavanja na osnovu prirode posla.

Poželjno je i znanje stranih jezika.

Poželjno poznavanje rada na računaru Word-Excell.

Radno iskustvo: 1 godina

Poslovi i radne obaveze:

- primio i prosledio poštu i evidentirao je u internim knjigama za dostavu;
- vodi evidenciju o vremenu odsustva radnika u administrativnim službama
- savija i sređuje dokaze koji se uvek čuvaju kao arhiva;
- obavlja poslove na računaru;
- vodi evidenciju službenih putovanja;
- sačinjava godišnji i mesečni plan potreba službenog materijala i drugog materijala;
- obavlja i druge poslove po nalogu direktora i sekretara preduzeća;
- za svoj rad odgovara sekretaru i glavnom izvršnom direktoru preduzeća.

3. KURIR - DRŽAČ HIGIJENE

Broj lidera: 1

Obrazovanje: KV ili polukvalifikovani radnik.

Radno iskustvo: 1 godina

Poslovi i radne obaveze:

- vrši direktnu dostavu pošte, hitne isporuke i dobija pismene informacije od poslovnih partnera i drugih;
- obavlja različite poslove van prostorija preduzeća;
- održavaju čistoću poslovnog prostora;
- održavaju kompletan inventar i cveće;
- za svoj rad odgovara sekretaru i glavnom izvršnom direktoru preduzeća.
- čišćenje kancelarija i zgrade uopšte,
- čišćenje toaleta,

- čišćenje dvorišta i prostora oko zgrade,
- obavlja i druge slične poslove iz svog delokruga,
- obavlja i druge poslove po osnovu delatnosti preduzeća i naloga pretpostavljenog,
- Za svoj rad odgovara sekretaru preduzeća.

4. LIDER NA TRŽIŠTU VOZILA I MOBILNOM TRŽIŠTU

Broj lidera: 1

Školska priprema: srednja škola, poznavanje rada na računaru Vord i Ekcell

Radno iskustvo: 1 godina

Poslovi i radne obaveze:

- obavlja poslove po dogovoru sa Opštinom Priština za upravljanje Auto pijacom,
- Vodi računa o redu i redu unutar Auto pijace i van nje,
- priprema nedeljne i mesečne izveštaje i dostavlja ih službeniku za finansije i trezor,
- saraduje sa Komisijom, koju imenuje Opština Priština,
- Svakog radnog dana radi po svom planu rada koji je odobrio finansijski direktor i koordinira rad sa radnicima koji rade na ovom tržištu,
- snosi odgovornost prema ugovoru o radu za sprovođenje sporazuma sa Opštinom Priština i uredbi koje dolaze od finansijskog direktora,
- obavlja poslove po dogovoru sa opštinom, odlukama ili dopisima komisija ili opštine,
- Obavlja poslove prema poslovnom planu preduzeća i nalozima finansijskog službenika i trezora
- brine o redu i redu na mobilnom tržištu,
- Svakog radnog dana radi po svom planu rada koji je odobrio finansijski direktor i koordinira rad sa radnicima koji rade na ovom tržištu,
- snosi odgovornost prema ugovoru o radu za sprovođenje sporazuma sa Opštinom Priština i uredbi koje dolaze od finansijskog direktora,
- obavlja i druge poslove koje mu poveri uprava,
- Za svoj rad odgovoran je i službeniku za finansije i trezor
- Glavni izvršni direktor preduzeća.

☉

5. POMOĆNI KOLEKTORA

Broj lidera: 2

Školska priprema: srednja škola, poželjno poznavanje rada na računaru.

Radno iskustvo: 1 godina

Poslovi i radne obaveze

- vrši naplatu od korisnika usluga i materijalno naplaćuje ulaznice,
- za svaki dan isporučuje dnevnu kupovinu i naplaćuje se ulaznicama i preuzimanju,
- popunjava formular za dnevni rad u Lauri parka „Germia“, na pijaci vozila kao i na drugim radnim mestima koje odredi preduzeće na plaćanju odgovarajućih usluga,
- obavezno je da se sve nepravilnosti koje se eventualno pojave na kartama vrate u računovodstvo,
- dužan je da se pravilno ponaša na terenu i da nosi za to predviđenu uniformu
- za svaki dan daje izveštaje predradniku za inkasant ili računovodstvo
- obavlja i druge poslove po nalogu finansijskog referenta ili poslovode inkasatora,
- za svoj rad odgovara izvršnom direktoru i finansijskom i trezorskom službeniku preduzeća.

6. PREDSTAVNIK PROIZVODNJE

Broj lidera: 1

Školska priprema: Srednja stručna škola, Gimnazija, Ekonomska škola i dr. Poznavanje rada na računaru Vord-Ekcell

Radno iskustvo: 1 godina

Poslovi i radne obaveze:

- direktno učestvuje u proizvodnji rasada, zelenila, cveća i brine o njihovom uzgoju,
- Voditi razvoj svih novih proizvoda u plastenicima i rasadnicima,
- stara se o blagovremenom završetku poslova radi postizanja što povoljnijih rezultata u proizvodnji,
- Kada misli da su proizvodi spremni za prodaju, on ih prenosi kroz proces, u gotovu robu,
- Brine da su radnici stalno prisutni i prenosi doprinos i kvalitet svog rada,
- vodi evidenciju radnika,
- obavlja i druge poslove po osnovu delatnosti preduzeća i naloga pretpostavljenog,
- Za svoj rad odgovoran je koordinatoru Radne jedinice i Izvršnom direktoru Preduzeća

7. GROBLJE PREDSTAVNIK

Broj lidera: 1

Školska priprema: Srednja stručna škola, gimnazija, ekonomska i dr., kao i poznavanje Vord-Ekcell računara.

Radno iskustvo: 1 godina

Poslovi i radne obaveze:

- obavljati poslove otvaranja mezara u skladu sa verskim odredjenjima,
- brine o radu i zelenilu u okviru groblja,
- odgovore o održavanju grobova po potpisanim ugovorima,
- odgovore u vezi praćenja radova na podizanju spomenika,
- vodi evidenciju o detaljnom planu i kartonu za groblje;
- vodi evidenciju grobova, sprovodi leševe kao i nadgleda rad čuvara na grobljima, vrši nadzor nad finansijskim radom ove službe,
- obavlja i druge poslove na osnovu delatnosti preduzeća i naloga pretpostavljenog,
- za svoj rad odgovara koordinatoru i glavnom izvršnom direktoru Preduzeća;

8. DEPOIST U ZAŠTIĆENOM PRIRODNOM PEJZAŽU "GERMI"

Broj lidera: 1

Obrazovanje: srednja škola, poželjno poznavanje rada na računaru.

Radno iskustvo: 1 godina

Poslovi i radne obaveze:

- Organizuje rad u magacinu,
- odgovoran je za prijem sa pravilima deponovanja, skladištenja i isporuke robe,
- materijalno i finansijski odgovoran za svu robu u magacinu,
- skladišti alat, materijal i sve gotove proizvode,
- vodi dokumentaciju za ulazak i izlazak,
- Zaposlen je i kao stražar u nadležnoj jedinici,
- obavlja i druge poslove na osnovu delatnosti preduzeća i naloga pretpostavljenog,
- Za svoj rad odgovara glavnom radniku i koordinatoru jedinice preduzeća.

9. PILE U ZAŠTIĆENOM PRIRODNOM PEJZAŽU „GERMI“

Broj lidera: 1

Školske pripreme: VSS, Fakultet za menadžment u turizmu, Fakultet istorije, geografije i srodnih predmeta - poznavanje rada na računaru Vord i Ekcell

Radno iskustvo: 1 godina

Poslovi i radne obaveze:

- Informiše posetioce o prirodnim vrednostima regionalnog parka "GERMIA",
- poštovanje i sprovođenje zakona o zaštiti prirode,
- Učešće u izradi i realizaciji dugoročnih i srednjoročnih programa regionalnog parka „GERMIA“,
- Prati i informiše posetioce o značaju regionalnog parka "GERMIA",
- obavlja i druge poslove na osnovu delatnosti preduzeća i naloga pretpostavljenog,
- Za svoj rad odgovara glavnom radniku i koordinatoru jedinice „GERMISA“.

10. FIZIČKI RADNICI NA ODRŽAVANJU I ZAŠTITI ZAŠTIĆENOG PRIRODNOG PREDELA „GERMI“

Broj glava: 4

Školska priprema: osnovna ili srednja škola

Radno iskustvo: Poželjno

Poslovi i radne obaveze:

- direktno učestvuje u svim poslovima koji se odnose na zaštitu zaštićenog prirodnog pejzaža "Germia",
- obavlja sve poslove na uređenju i održavanju zelenih površina, kao i na zaštiti zaštićenog prirodnog pejzaža „Germia“,
- obavlja i druge poslove na osnovu delatnosti preduzeća i naloga pretpostavljenog,
- za svoj rad odgovara predradniku i koordinatoru radne jedinice.

Potrebna dokumentacija za konkurs:

- Prijava za prijem u radni odnos prima se u Arhivu preduzeća
- Izjava pod zakletvom,
- kopiju lične karte,
- potvrda suda da niste pod istragom,

- uverenje o radnom iskustvu,
- Kopije dokumentacije o pripremi škole.

Podnošenje dokumentacije za Prijavu vrši se svakog radnog dana, od 08:00 - 15:00 časova, u Arhivu NPL „HORTIKULTURA“ SH, Adresa: Ul. „Tahir Zajmi“ p.n. (kod Gradskog saobraćajnog centra) Priština
Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Abrypa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Drilon Shigjeqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Vëllezërit Frashëri " Pllanej.

- Alned Mustafi shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Shkendija Agushaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Zenun Cocaj " Gjonaj.

- Hikmete Lusnjani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme SH.M.L "Dardania" Hani Elezit.

- Lumturije Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Borë Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M "Selman Riza", nga klasa e -I- deri -VIII-, Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së -IX- të SH.M.T "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe

dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales